VENDIM
Nr. 376, datë 12.6.2024

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK BASHKIA KLOS, TË PRONËS NR. 718, ME EMËRTIMIN "ISH-GRUP-DEPO ARMATIM-MUNICION", KLOS, ME VENDNDODHJE NË ZONAT KADASTRALE 1137 E 2164, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, E PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 1099, DATË 30.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Klos, të pronës nr. 718, me emërtimin "Ish-grup-depo armatim-municion", Klos, me vendndodhje në zonat kadastrale 1137 e 2164, sipas formularit dhe plan-rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim për ta përdorur për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.
2. Në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, në listën e inventarit, bashkëlidhur vendimit, përmasat e pronës nr. 718, me emërtimin "Ish-grup-depo armatim-municion", Klos, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin dhe plan-rilevimin, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
3. Prona nr. 718 hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar.
4. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1099, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Bashkinë Klos, të qarkut të Dibrës".
5. Bashkisë Klos i ndalohet ndryshimi i destinacionit dhe tjetërsimi i pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.
6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Klos dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

	Identifikoi pronën	**Kapiten Reldion Kole / Specialist i Infrastrukturës i Forcës Tokësore** (Emri, Mbiemri, Pozicioni Zyrtar)
Institucioni Qendror Shtetëror **MINISTRIA E MBROJTJES**	**Supervizoi**	**Nënkolonel Revis Xhepa / Shef i Degës Logjistike i Forcës Tokësore** (Emri, Mbiemri, Pozicioni Zyrtar)
	Aprovoi	**Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia / Komandant i Forcës Tokësore** (Emri, Mbiemri, Pozicioni Zyrtar)

Nr.	Zona Kadastrale Indeksi i Hartës	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Emërtesa e Pasurisë Adresa	Sip. e pasurisë (m2)	Nga sip		Funksioni që përdoret	Institucioni me përgjegjësi administrative / pronësi	Institucioni përdorues i pronës Statusi juridik i përdorimit	Inventarizuar me VKM	Të dhëna të tjera
						Truall (m2)	Ndërtesë (m2)					
718				**Ish Grup Depo Armatim- Municion, Klos, Burrel**				**Për mbrojtjen**	**Ministria e Mbrojtjes**	**Komanda e Forcës Tokësore (Rep. Ushtarak Nr.1001 - Rep. Ushtarak Nr.1013)**	**VKM Nr. 515 datë 18.07.2003, i ndryshuar me VKM 737/2012**	
	1137 K-34-89-(132-A)	40/17-A	Truall ndërtesë	Objekti Nr.1 - Depo veshmbathje	13328	13328	412,92					Ndodhet një objekt informal
	1137	40/15-A	Truall	Truall funksional	4594	4594						
	1137	40/15-C	Truall	Truall funksional	3365	3365						Ndodhet një objekt informal
	2164	127/11-A	Shkëmbore	Truall funksional	391	391						
				Total	**21678**	**21678**	**412,92**					

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
Prona nr.718 " Grup Depo AM" Klos, Mat

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË (MM) DATË 25/03/2024 QËLLIMI Përditësim, Regjistrim

VENDNDODHJA
Bashkia Klos ZVASHK Mat Nr.Pasurisë 40/15, 40/17, 127/11 Z.K 1137, 2164 Indeksi i Hartës K-34-89-(132-A)

TE DHËNAT E PASURISË
Lloi i pasurisë_____ Sip e pasurive **53805m²** Sip e gjurmës së ndërtimit Nr. kateve 1 Nr. pemeve____

Nord =4595962.25
East = 507639.31

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord =4595962.25
East = 508079.22



Shpjeguese:

- Kufiri i pronës nr. 718 sipas VKM nr.737, datë 16.10.2012
- Sip. e pasurisë nr 40/17-A sipas Faktit = 13328m²
- Sip. e gjurmë së ndërtimit të objektit nr.1 = 412.92m²
- Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit informal = 152m²
- Sip. e pasurisë nr 40/15-A sipas Faktit = 4594m²
- Sip. e pasurisë nr 40/15-C sipas Faktit = 3365m²
- Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit informal = 76m²
- Sip. e pasurisë nr 127/11-A sipas Faktit = 391m²

Sip. e Përgj. sipas faktit e pasurive me nr. 40/17-A+ 40/15-A+ 40/15-C+127/11-A = 21678m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr 1= 412.92m²

Nord =4595611.18
East = 507639.31

SH 1: 2500
METRA

Nord =4595611.18
East = 508079.22

NR ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1 Veri				K51726024H
2 Lindje				
3 Jug				
4 Perendim				

REALIZOI PËR IGJIU
Ing. Eris Ndrukaj

KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI MArch. Teuta **KANXHERI**

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti_____
DVASHK_____
Nënshkrimi_____
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori_____
Nënshkrimi/ Vula_____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE Z-Zyrë; O-Ortofoto.
PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas dokumentacionit hartografik arkivor, HTR.
Shënim: Ky plan rilevimi u hartua në zbatim të shkresës të Komandës të FT nr.438/1, datë 23.01.2024. Bazuar në dokumentacionin hartografik marrë në arkivin e IGJIU-s, HTR-së dhe kartelat e pasurive , azhornimit në terren në b/punim me përfaqsuesit e FT, ortofoto e vitit 2015-2016.

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM (Forca Tokësore)
MIRATOHET
KOMANDANTI I FORCËS TOKËSORE
Gjeneral Major Ilir **XHEBEXHIA**